REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr._____prot. Lushnjë, më ____/_____/ 2025

MIRATOHET
KRYETAR
Eriselda Sefa

Lënda:Mekanizëm për Shpërblime Jofinanciare për stafin me Performancë të lartë në Bashkia Lushnjë.

Ky mekanizëm synon:motivimin e punonjësve me performancë të lartë;promovimin e kulturës së meritokracisë;rritjen e eficiencës dhe angazhimit institucional;vlerësimin publik të kontributit profesional dhe etik të stafit.

I. *KRITERET E VLERËSIMIT*

Punonjësit vlerësohen mbi bazën e:

-realizimit të objektivave të punës;

-korrektësisë dhe etikës profesionale;

-inovacionit dhe iniciativave në punë;

-bashkëpunimit në grup;

-komunikimit me qytetarët;

-pjesëmarrjes në aktivitete institucionale;

-respektimit të afateve dhe procedurave.

Vlerësimi kryhet periodikisht (çdo 6 muaj ose 1 vit).

II. *FORMAT E SHPËRBLIMEVE JOFINANCIARE*

1. Vlerësime Publike dhe Institucionale

-Certifikatë mirënjohjeje nga Titullari i Institucionit nw fund tw vitit;

-Evidentim si "Punonjësi i Vitit";

-Publikim i vlerësimit në faqen zyrtare ose rrjetet sociale të institucionit;

-Falënderim publik gjatë mbledhjeve institucionale.

2. Mundësi Promovimi Profesional

-Prioritet për ngritje në detyrë sipas legjislacionit në fuqi;

-Përfshirje në role koordinuese ose drejtuese;

-Angazhim në grupe pune strategjike;

-Përfaqësim i institucionit në aktivitete kombëtare apo rajonale.

3. Pjesëmarrje në Projekte dhe Trajnime

-Përfshirje në projekte zhvillimore dhe inovative;

-Prioritet në trajnime profesionale;

-Mundësi pjesëmarrjeje në konferenca, workshope dhe seminare;

-Përfshirje në programe shkëmbimi eksperience.

III. *PROCEDURA E PËRZGJEDHJES*

Çdo drejtori propozon punonjësit me performancë të lartë.

Një komision vlerësimi shqyrton performancën mbi bazën e dokumentacionit dhe rezultateve konkrete.Përzgjedhja bëhet në mënyrë transparente dhe të dokumentuar.Vendimi miratohet nga Titullari i Institucionit.

IV. *PARIMET E ZBATIMIT*

Mekanizmi bazohet në:

-meritokraci;

-transparencë;

-barazi mundësish;

-motivim profesional;

-integritet institucional.

V. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ky mekanizëm zbatohet për të gjithë punonjësit e institucionit dhe rishikohet periodikisht në përputhje me nevojat organizative dhe politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Erisa Qalliu